| 75 | 80613105 | Metel Restorant "Sofra" | Ferizaj | 10.02.2006 | 04.05.2006 | 04.05.2011 | 10 | 20 | 11 | 3 | Rr.Vllezerit Gervalla - Ferizaj | 044/255.904 | |
| 76 | 70148195 | Motel "Sofra" | Ferizaj | 10.02.2006 | 04.05.2006 | 04.05.2011 | 21 | 21 | 5 | 2 | Rr.Vllezerit Gervalla - Ferizaj | 044/378.889 | |
| 77 | 80049412 | Hotel "Gorejne" | Prishtine | 14.02.2006 | 04.05.2006 | 04.05.2007 | 18 | 36 | 23 | | Veternik - Prishtine | 044/202.561 | |
| 78 | 70062250 | Motel Resoran "City" | Prizren | 28.02.2006 | 04.05.2006 | 04.05.2011 | 9 | 18 | 7 | 3 | Rr.Edi Durham 113 Prizren | 044/636.986 | |
| 79 | 80474652 | Motel "Gjilani" | Gjilan | 28.02.2006 | 08.03.2006 | 08.03.2011 | 16 | 32 | 5 | | Rr. Dardania 8/14 Gjilan | 044/233.360 | |
| 80 | 80454791 | Motel "Thana" | Kline | 28.02.2006 | 08.03.2006 | 08.03.2011 | 18 | 36 | 5 | 10 | Kline | 044/165.125 | |
| 81 | 70048421 | Hotel"Kosova Park" | Istog | 16.03.2006 | 20.03.2007 | 20.03.2012 | 11 | 22 | 16 | 10 | Banje - Istog | 044/640.008 | |
| 82 | 70093760 | Motel Restoran "Zani" | Lipjan | 17.03.2006 | 03.05.2007 | 03.05.2012 | 7 | 8 | 4 | | Magj Lipjan - Prizren | 044/136.805 | |
| 83 | 80698771 | Motel " Luxor" | Prishtine | 20.03.2006 | 04.05.2006 | 04.05.2007 | 15 | 21 | 8 | | Rr.Nazim Gafurri Pn | 038/517.888 | |
| 84 | 70143671 | Hotel "Xhema" | Prishtine | 21.03.2006 | 04.05.2006 | 04.05.2011 | 8 | 16 | 4 | | Rr.Maliq Pashe Gjinoli Nr 8 | 044/177.665 | |
| 85 | 70291142 | Hotel"Amsterdam" | Gjakove | 03.04.2006 | 04.05.2006 | 04.05.2007 | 17 | 34 | 10 | | Rr.Mithat Frasheri - Gjakove | 044/129.020 | |
| 86 | 70212519 | Motel "Euro Benz" | Malisheve | 06.04.2006 | 04.05.2006 | 04.05.2011 | 7 | 14 | 7 | | Magjstralja - Peje-Prishtine | 044/152.285 | |
| 87 | 80344767 | Motel Resto | Shtime | 07.04.200 | 17.01.200 | 17.01.201 | 9 | 18 | 3 | | Davidovc - | 044/201.866 | |

| | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | "Titanic" | | 6 | 8 | 3 | | | | | Shtime | | |
| 88 | 80447086 | Motel "Aldi" | Prishtine | 12.04.2006 | 04.05.2006 | 04.05.2007 | 7 | 14 | 5 | | Çagllavice - Prishtine | 044/120.907 | |
| 89 | 70134465 | Hotel "Europe" | Gjakove | 12.04.2006 | 04.05.2006 | 04.05.2007 | 9 | 18 | 8 | 15 | Rr.Pashko Vasa - Gjakove | 044/604.729 | |
| 90 | 80631189 | Motel "Muhaxheri" | Ferizaj | 12.04.2006 | 06.06.2008 | 06.06.2009 | 15 | 30 | 6 | 3 | Rr.Rexhep Bislimi | 044/207.024 | |
| 91 | 80123981 | M.Europa92 M Binjak | Prishtine | 26.04.2006 | 05.01.2006 | 05.01.2011 | 20 | 40 | 13 | 8 | Lapnaselle - Prishtine | 044/503.457 | |
| 92 | 80596235 | Motel "Niki" | Hani I Elezit | 26.04.2006 | 04.05.2006 | 04.05.2011 | 9 | 18 | 4 | | Hani i Elezit | 044/228.296 | |
| 93 | 70059721 | Motel Restoran Gryka | Peje | 17.05.2006 | 16.11.2006 | 16.11.2011 | 7 | 14 | 4 | 3 | Rr.Peje Kuqisht | 044/148.348 | |
| 94 | 70341599 | Hotel"Fenix" | Prishtine | 24.05.2006 | 0 | 0 | 7 | 14 | 3 | | Prishtine | 044/626.459 | Mbyllur |
| 95 | 70034543 | Motel "Kosova" | Rahovec | 30.05.2006 | 16.11.2006 | 16.11.2011 | 8 | 18 | 7 | 6 | Magji.Gjakove-Prizren | 044/254.841 | |
| 96 | 70322863 | Motel "Brooklyn" | Ferizaj | 24.07.2006 | 04.05.2006 | 04.05.2011 | 9 | 18 | 8 | | Rr.Qamil Ilazi - Ferizaj | 044/627.765 | |
| 97 | 70347396 | Motel "Agora" | Lipjan | 08.08.2006 | 16.11.2006 | 16.11.2007 | 10 | 20 | 4 | | Rr.Skederbeu Lipjan | 044/671.747 | |
| 98 | 70008790 | H. "Dona Internacional | Peje | 25.08.2006 | 16.11.2006 | 16.11.2011 | 20 | 36 | 10 | | Rr.Besnik Lajqi Pn | 039/31.296 | |
| 99 | 70362790 | Hotel"Royal" | Prishtine | 25.08.2006 | 16.11.2006 | 16.11.2011 | 14 | 28 | 14 | | Rr.Pashko Vasa Nr 3 | 044/160.300 | |
| 100 | 70175991 | Motel Restoran"Lea" | Lipjan | 25.08.2006 | 04.05.2006 | 04.05.2011 | 18 | 36 | 15 | | Magjstrlja Prishtine - Lipjan | 044/222.248 | |
| 101 | 70418968 | Motel "Dardani" | Mitrovicë | 30.03.2007 | 11.09.2007 | 11.09.2012 | 15 | 17 | 4 | | Fshati Shupkovc -Mitrovice | 044/747.331 | |
| 102 | 80584610 | Hotel"Lyon" | Prishtine | 30.03.2007 | 17.01.2008 | 17.01.2009 | 17 | 24 | 7 | | Rr.Rrustem Statovci Nr.91 | 044/220.997 | |
| 103 | 70262185 | Bujtina"Villa Liria" | F.Kosovë | 05.04.2007 | 17.01.2008 | 17.012009 | 12 | 14 | 4 | | Zona Industriale Fushe Koso | 044/127.011 | |
| 104 | 70219422 | Motel"Berati" | F.Kosovë | 06.04.2007 | 17.05.2007 | 17.05.2008 | 7 | 7 | 6 | | Sllatine - Fushe Kosove | 04/257.156 | |
| 105 | 80035616 | Hotel "Inter Evropa" | Gjilan | 06.04.2007 | 17.05.2007 | 17.05.2012 | 7 | 14 | 7 | | Magjstralja Gjilan - Ferizaj | 044/112.095 | |
| 106 | 70383256 | Motel Resto "Harea" | Lipjan | 11.04.2007 | 17.05.2007 | 17.05.2012 | 10 | 10 | 3 | | Rr.Prishtine - Ferizaj | 044/507.917 | |
| 107 | 70312498 | Hotel"Ambasador" | Prishtine | 16.04.2007 | 17.05.2007 | 17.05.2012 | 18 | 18 | 15 | 2 | Rr.Adrian Krasniqi Nr.1 | 044/362.923 | |
| 108 | 80689497 | Motel "Niti - B " | Viti | 17.04.2007 | 17.01.2008 | 17.01.2013 | 14 | 16 | 5 | | Kllokot - Viti | 044/193.861 | |
| 109 | 70349786 | Hotel"Kristal" | Gjilan | 26.04.2007 | 17.05.2007 | 17.05.2012 | 40 | 80 | 40 | 10 | Rr.Skenderbeu Nr.39 | 044/125.602 | |
| 110 | 70017677 | Motel "Luassana" | Ferizaj | 03.05.2007 | 17.05.2007 | 17.05.2012 | 15 | 20 | 4 | | Rr.Rexhep Bislimi - Ferizaj | 044/142.397 | |
| 111 | 70026257 | Hotel "Vita" | F.Kosovë | 03.03.2007 | 17.05.2007 | 17.05.2012 | 19 | 25 | 14 | | Fshati Vrogoli - F. Kosove | 044/189.923 | |
| 112 | 70048034 | Hotel "Royal" | Peje | 10.05.200 | 15.06.200 | 15.06.201 | 16 | 32 | 16 | 4 | Rr.Toni Bler Nr | 044/134.890 | |

| | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | 7 | 7 | 2 | | | | | .2 | | |
| 113 | 70103577 | Motel"Argjena" | Dragash | 10.05.2007 | 02.10.2007 | 02.10.2012 | 11 | 40 | 11 | | Fshati Brod - Dragash | 044/502.368 | |
| 114 | 80137800 | Hotel "Genti" | Mitrovice | 10.05.2007 | 11.09.2007 | 11.09.2012 | 14 | 14 | 4 | | Mitrovoce | 044/213.860 | |
| 115 | 80386117 | Motel "Denisi" | Istog | 14.05.2007 | 21.04.2008 | 21.04.2013 | 8 | 16 | 6 | | Dobrushe -Istog | 044/225.000 | |
| 116 | 80283873 | Motel "Venera" | Prishtine | 24.05.2007 | 02.10.2007 | 2.102008 | 8 | 10 | 5 | | Veternik - Prishtine | 044/665.921 | |
| 117 | 80459050 | Motel"Porta" | F.Kosovë | 31.05.2007 | 17.01.2008 | 17.01.2013 | 8 | 8 | 4 | | Sllatine - Fushe Kosove | 044/208.183 | |
| 118 | 80361165 | Hotel "Las Vegas" | Ferizaj | 31.05.2007 | 17.05.2007 | 17.05.2008 | 14 | 16 | 4 | 2 | Rr. Rexhep Bislimi - Ferizaj | 044/591.677 | |
| 119 | 70134431 | Hotel "Bolero" | Ferizaj | 04.05.2007 | 22.01.2008 | 22.01.2013 | 6 | 12 | 10 | | Deshmoret e Kombit | 044/135.856 | |
| 120 | 80695993 | Motel "Hana Tex" | Shtime | 04.05.2007 | 15.06.2007 | 15.06.2012 | 9 | 16 | 3 | | Rr.Komandant Kumanova | 044/141.623 | |
| 121 | 70179011 | M.Kroni I Mbretit" | Drenas | 06.06.2007 | 17.01.2008 | 17.01.2013 | 7 | 9 | 4 | | Krrotice e Eperme - Drenas | 044/750.827 | |
| 122 | 70012455 | Motel "Paradis" | Prizren | 20.06.2007 | 22.01.2008 | 22.01.2009 | 7 | 14 | 4 | 2 | Ëiliam Ëoker - Prizren | 044/290.954 | |
| 123 | 80046847 | Hotel "Dea" | Prishtine | 27.06.2007 | 17.02.2008 | 17.02.2013 | 17 | 32 | 5 | | Velani - Prishtine | 044/555.929 | |
| 124 | 80116489 | Hotel "ORA" | Prishtine | 28.06.2007 | 17.01.2008 | 17.01.2009 | 27 | 27 | 15 | 3 | Prishtine -Rr. Çajupi | 044/700.268 | |
| 125 | 70277021 | Motel "Antika" | Peje | 28.06.2007 | 17.01.2007 | 17.01.2008 | 7 | 7 | 12 | 5 | Vitomirice - Peje - Razhaj | 044/348.028 | |
| 126 | 70052029 | Hotel " OK " | Prizren | 02.07.2007 | 17.01.2008 | 17.01.2013 | 24 | 48 | 19 | 5 | Lugishte - Prizren | 044/113.362 | |
| 127 | 70216662 | Hotel Res "Kalaja" | Viti | 06.07.2007 | 05.01.2006 | 05.01.2011 | 13 | 26 | 9 | 2 | Kllokot - Viti | 044/322.634 | |
| 128 | 80206518 | M."Minatori Petroll" | Malisheve | 11.07.2007 | 04.04.2008 | 04.04.2013 | 9 | 18 | 4 | 1 | Terpeze e Ulet - Malisheve | 044/155.661 | |
| 129 | 80581998 | Motel "Evropa" | Drenas | 20.07.2007 | 17.02.2008 | 17.02.2009 | 7 | 14 | 3 | | Llapushnik - Drenas | 044/269.463 | |
| 130 | 70301054 | Motel "Excluziv" | Lipjan | 26.09.2007 | 17..03.2008 | 17.03.2013 | 10 | 10 | 6 | | Konjuh - Lipjan | 044/610.993 | |
| 131 | 70426082 | Hotel "Pllaza" | Prishtine | 27.09.2007 | 17.01.2008 | 17.01.2013 | 12 | 14 | 4 | | Rr.Luan Hajredinaj Nr.22 | 044/146.583 | |
| 132 | 70129015 | M."Besi-Company" | Suharekë | 28.09.2007 | 04.04.2008 | 04.04.2013 | 7 | 8 | 4 | | Duhel - Suhareke | 044/520.520 | |
| 133 | 70429096 | Motel "Fati" | Ferizaj | 09.10.2007 | 17.02.2008 | 17.02.2013 | 10 | 20 | 5 | 2 | Muhovc - Ferizaj | 044/325.296 | |
| 134 | 70443604 | Motel "Gjeneva" | Gjilan | 19.10.2007 | 17.06.2008 | 17.06.2013 | 12 | 12 | 4 | | Parallove - Gjilan | 044/361.447 | |
| 135 | 80002432 | Hotel "Nora" | Kline | 06.11.2007 | 17.01.2008 | 17.01.2013 | 30 | 60 | 20 | 4 | Gllareve - Kline | 044/132.166 | |
| 136 | 70457808 | Hotel " Real " | Prishtine | 26.12.2007 | 17.02.2008 | 17.02.2009 | 12 | 12 | 5 | | Rr.Vaso Pasha - Prishtine | 044/170.148 | |
| 137 | 70422656 | Mot"Villa | Lipjan | 13.12.200 | 17.02.200 | 17.02.200 | 15 | 15 | 12 | 4 | Zona Industriale | 044/250.999 | |

| | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Marigona" | | 7 | 8 | 9 | | | | | - Lipjan | | |
| 138 | 80468474 | Motel "Valdrini" | Ferizaj | 11.03.2008 | 17.06.2008 | 17.06.2009 | 14 | 14 | 4 | | 13 Qershori - Ferizaj | 044/279.438 | |
| 139 | 70009710 | Motel "Donarti" | Prishtine | 15.04.2008 | 21.04.2008 | 21.04.2013 | 10 | 16 | 7 | | Bil Clinton Nr 57/A | 044/176.262 | |
| 140 | 70163202 | Hotel"Europa | Prishtine | 15.042008 | 21.04.2008 | 21.04.2009 | 7 | 14 | 5 | | Robert Dol Nr.23 | 044/656.045 | |
| 141 | 70426594 | Motel "Shpati" | Obiliç | 24.04.2008 | 06.06.2008 | 06.06.2013 | 10 | 10 | 5 | | Magj.Prishtine - Obiliç | 044/206.711 | |
| 142 | 70335066 | Hotel'Art-Nis" | Istog | 24.04.2008 | 06.06.2008 | 06.06.2013 | 10 | 25 | 8 | 6 | Deshmoret e Kombit | 044/282.068 | |
| 143 | 80009259 | Motel AS | Ferizaj | 27.12.2005 | 24.12.2008 | 24.12.2013 | 18 | 37 | 7 | 10 | Rr. E Prizrenit - Ferizaj | 044/120.471 | |
| 144 | 70101320 | Metel "Bonita" | Ferizaj | 12.05.2008 | 05.01.2006 | 05.01.2007 | 7 | 14 | 5 | | Rr magj . Prishtine - Ferizaj | 044/121.398 | |
| 145 | 70289442 | Hotel "Metropoll" | Gjakove | 31.01.2008 | 24.12.2008 | 24.12.2013 | 14 | 16 | 4 | 1 | Rr. Nenena Tereze PN | 044/388.169 | |
| 146 | 70038549 | Hotel Berisha | Kline | 26.06.2007 | 24.12.2008 | 24.12.2013 | 10 | 20 | 8 | 2 | Magj -Prishtine Peje | 044/302.434 | |
| 147 | 70350221 | Hotel Grand | Prishtine | 05.06.2008 | 24.12.2008 | 24.12.2013 | 286 | 292 | 248 | 20 | Prishtine | 044/503.930 | |
| 148 | 70006582 | Motel Te Arberi | Lipjan | 21.10.2008 | 24.12.2008 | 24.12.2013 | 19 | 38 | 6 | 2 | RR. Robert Gajdiku | 044/271.491 | |
| 149 | 70436314 | Motel Arena | Obiliç | 13.11.2008 | 24.12.2008 | 24.12.2013 | 11 | 14 | 5 | | Prugovc - Prishtine | 044/233.553 | |
| 150 | 70374111 | Hotel Jehona | Kamenice | 22.06.2007 | 24.12.2008 | 24.12.2013 | 7 | 2 | 10 | 12 | Abdullah PrershevaNr.30 | 044/222.519 | |

UNIVERSITETI I SHKENCAVE ORGANIZATIVE
PJETËR BUDI
INSTITUTI PËR STUDIME - PRISHTINË

FAKULTETI TURIZËM HOTELERI

# Turizmi në Kosovë

## Arife Muji

Tel : +381 38 234 566; +377 44 163 372; +386 49 163 372 e-mail: info@universitetipjeterbudi.com
www.universitetipjeterbudi.com

**Faktorët e zhvillimit të turizmit në Kosovë**

Me qëllim të identifikimit të faktorëve përcaktues për zhvillimin e turizmit të një vendi është me rëndësi që të njihemi edhe me disa nga treguesit më të rëndësishëm ekonomik. Në vijim po prezantojmë në formë tabelare disa prej treguesve.

**Faktorët natyrorë si motive turistike**

Kosova ka shanse të mrekullueshme për zhvillim të turizmit. Disponon me atraksionet natyrore të begatshme, me lokacione gjeografike të volitshme. Disa prej përparësive të saj turistike të veçanta janë veçoritë e dallueshme morfologjike, hidro-grafike, klimatike dhe elemente të tjera atraktive te cilat e bëjnë Kosovën një nder hapësirat turistike më tërheqëse në rajon.
Edhe pse Kosova nuk posedon disa faktorë, të cilët kanë ndikim tërheqës, në pjesën më të madhe të kërkesës turistike, siç është deti, ajo disponon me potencial të jashtëzakonshëm natyror dhe mundësi tjera për zhvillimin e gati të gjitha formave të turizmit, në radhë të pare, të turizmit dimëror-sportiv, malorë, shëndetësorë, transit, gjuetisë turizmit të biznesit etj. Studimet e bëra kanë treguar se në Kosovë ekzistojnë mundësi për ndërtimin e 20 qendrave të turizmit dimëror, të cilat mund të ofrojnë kushte shumë të mira për zhvillimin e turizmit dimëror-sportive, sipas standardeve ndërkombëtare.

Përveç mundësisë së ngritjes së qendrave turistike për zhvillimin e formave tjera turistike duhet pasur parasysh si: Grykën e Rugovës, e cila me bukuritë e saj të rralla, paraqet atraksion të posaçëm, Shala e Bajgores, ofron kushte shumë të mira për zhvillimin e llojeve të caktuara të turizmit, pastaj burimi i Drinit të Bardhë, liqenet natyrale, Shpella e Gadimës, Radavcit, në Grykë të Rugovës, Panorc,

Petreshticë, Bresalc etj. Nga atraksionet tjera duhet veçuar, Ujëvarën Mirusha, Bifurkacionin e lumit të Nerodimës etj. Nga burimet e ujërave termale mundësi turistike ofrojnë Banja e Pejës, Kllokotit dhe Banja e Mitrovicës dhe burime tjera termale.
Ndër faktorët më të rëndësishëm natyror që mundësojnë zhvillimin e turizmit në Kosovë mund të përmenden:

- Pozita gjeografike i mundëson qasje të favorshme në tregun turistik rajonal dhe më gjerë;
- Kushtet klimatike të favorshme;
- Relievi i thyer kodrinor dhe malor, i pasur me shumëllojshmëri të florës dhe faunës, natyra dhe ekologjia i krijojnë kushte për zhvillimin e turizmit të gjelbër;
- Atraksionet turistike si shpellat, grykat, kantonet, lumenjtë, liqenet etj.

## Motivet gjeomorfologjike

Me motive gjeomorfologjike nënkuptohen format më tërheqëse në relievin e tokës që kanë në vete atribute tërheqëse për turistët. Vështruar nga aspekti hapësinor motivet gjeomorfologjike duhet të kihen parasysh relacionet ndërmjet pikave të ndryshme tokësore, të paraqitura me elementet e lartësive mbidetare, gjegjësisht ultësirat dhe lartësirat e tokës. Vetitë rekreative të këtyre motiveve shprehen me komponentët relievore ndikimin e relievit në klimë, hidrografi, vegjetacion dhe jetën shtazore.

**Relievi** paraqet një prej elementeve më të dalluara të mjedisit, në veçanti ndryshimet gjeomorfologjie shumë më të pasura me atraktivitete se sa ato të ultësirave.
Të gjitha format relievore nuk janë njësoj tërheqëse dhe nuk e kanë të njëjtën vlerë turistike. Shikuar nga aspekti i formave të relievit që janë tërheqëse për turistët mund të përmenden: malet, shpellat, grykat, kanjonet etj.

Arkitektura e shkëmbinjve paraqet një spektakël me veçanti të një mjedisi gjeografik. Në përgjithësi të gjitha format gjeomorfologjive janë interesante si dukuri natyrore për qarkullime turistike.

**Grykat, kanjonet dhe shpellat si motive turistike** janë atraksione turistike që paraqesin forma të ngushta relievore të maleve që kanë anë vertikale. Estetika dhe kurioziteti që disponojnë grykat i bëjnë këto atraktive për turizëm. Edhe qafat malore hyjnë në kategorinë e grykave. Në Kosovë ekziston numër i konsiderueshëm i grykave, shpellave dhe kanjoneve. Alpet shqiptare dhe masivi i Sharit janë rajonet më të pasura me gryka, shpella dhe kanjone

.

**Grykat.** Më të njohura në Kosovë janë: Gryka e Rugovës, e Kaçanikut, Carralevës, Ibrit etj. Gryka e Rugovës me bukuritë e veta natyrore është gryka më e njohur në rajon dhe më gjerë.
Në Kosovë kanjoni më i njohur është kanjoni i Mirushës, i cili ka sistem prej 13 ujëvarave dhe 16 liqeneve të mëdhenj dhe të vegjël me një bukuri madhështore.

**Shpellat.** Paraqesin forma gjeomorfologjike për relievin, në turizëm kanë rol të veçantë për arsye se vizitat që iu bëhen kanë karakter turisti.
Në Kosovë përveç shpellës së Gadimes ka edhe shpella tjera, të cilat ende nuk janë të përgatitura për t'u vizituar nga turistet si: shpella e Radavcit, e Panorcit, Petreshticës, Bresalcit, në Grykë të Rugovës etj.

**Elementet hidrografike,** janë element mjaft i rëndësishëm i trashëgimisë natyrore të një vendi. Përmes ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore mund të tregohet kompleksi natyror i përbërjes gjeologjike, relievit, klimës, florës dhe faunës si dhe aktivitetit të njeriut për përshtatjen dhe shfrytëzimin e elementeve hidrografike për plotësimin e nevojave të ndryshme.
Pozitën gjeografike që ka Kosova, me lartësi mesatare (811m), mbyllja e hapësirës së saj me male të mesme dhe të larta në pjesët periferike krijuan kushte për formimin e nyjës hidrografike në Kosovë. Ujërat e Kosovës në Sukën e Dermanit në malin e Nerodimës ndahen dhe derdhen në tri pellgje: në detin Adriatik, Egje dhe në Detin e Zi.

**Lumenjtë,** atraktiviteti natyror që kanë lumenjtë në luginat e veta shërbejnë edhe për zhvillimin e turizmit. Rëndësia turistike e lumenjve, përveç përqendrimit në shfrytëzimin e tyre për larje, zhvillimin e sporteve, si noti, peshkimi etj, ata me kanjonet, grykat dhe ujëvarat që kanë, paraqesin atribute atraktive për zhvillim të turizmit. Lumenjtë e Kosovës janë të njohur me atraktivitetin dhe estetiken e tyre natyrore, që mund të përdorën për zhvillimin e turizmit.
Lumenjtë siç janë: Mirusha, Burimi i Drinit të Bardhë, Nerodimja etj. me atraktivitetin e tyre natyror mahnitës, janë atraksione mjaft interesante për turistët.

**Liqene,** ka po thuaj në të gjitha gjiret gjeografike dhe në lartësi të ndryshme mbidetare, të cilët kanë rëndësi për zhvillimin e turizmit, sidomos në vendet kontinentale, të cilat nuk kanë det. Për nga lloj i liqeneve dallohen liqenet akullnajor, lumor dhe relikte (artificial). Liqet e akullnajave janë më të bukurit prej të gjitha llojeve për arsye se ata gjenden në zonat malore dhe janë pjesë e pandashme e atraksioneve të masiveve malore. Kosova është e pasur me këto tri lloje të liqeneve. Liqene akullnajore në Kosovë ka më së shumti në Alpet Shqiptare dhe në Malet e Sharrit.
Në Alpet shqiptare janë të njohura këto liqene :

- Në Malet e Gjeravicës janë liqeni i madh, liqeni i vogël,
- Në Rugovë liqeni i Leqinatit;

Në Malet e Sharrit janë 16 liqene, prej tyre janë:

- Liqeni i Livadhit;
- Liqeni i Bogovinës;
- Liqeni i Zi ;
- Liqeni i Jazhicës;
- Liqeni i Sipërm etj.

Kosova ka edhe një numër të liqeneve artificiale, të cilët shfrytëzohen për ujë të pijshëm por edhe për zhvillimin e turizmit. Tabela në vijim prezanton liqenet artificiale të Kosovës.

| Lumi | Emërtimi i liqenit artificial |
|---|---|
| Ibër | "Gazivodë" |
| Batllavë | "Batllava" |
| Graçankë | "Badovc" |
| Prrue | "Radoniq" |
| Përlepnicë | "Përlepnicë" |

**Ujërat termale,** Kosova ka burime të rëndësishme të ujërave termale, të cilat shfrytëzohen për qëllime mjekësore dhe rekreative. Këto resurse nuk shfrytëzohen racionalisht e as nuk janë hulumtuar sa duhet. Zyrtarisht ekzistojnë vetëm tri qendra shëruese: Banja e Pejës, e Kllokotit dhe Banjëska (në veri të Mitrovicës). Megjithatë, ekzistojnë edhe burime tjera, të cilat nuk shfrytëzohen dhe nuk janë hulumtuar, më të njohura janë: burimi i ujit në Malishevë, Uglar, Poklek, Dobërqan, Lluzhan , Deçan etj.

## Motivet antropogjene

Oferta turistike e një vendi turistik është e përbërë nga motivet natyrore dhe motivet antropogjene. Motivet antropogjene janë faktorë atraktivë shoqëror, të cilët nxisin qarkullimin turistik. Numër i konsiderueshëm i turistëve, për të kënaqur kërshërinë e tyre turistike, vizitojnë vende të ndryshme historike, objekte të njohura kulturore. Motivet antropogjene janë objekt i qarkullimeve turistike, numër i madh i turistëve kërkojnë vende historike, objekte kulturore të njohura, fushëbeteja, ngjarje të rëndësishme historike etj, me qëllim të zgjerimit të njohurive të tyre dhe njohjes më përsëafermi të këtyre vlerave.

Vështruar për nga lloj, motivet antropogjene janë të llojllojshme, të cilat së bashku janë segment i rëndësishëm i ofertës turistike të një vendi. Bazuar në efektet dhe funksionet turistike që kanë mund të ndahen:

- Monumente kulturore-historike;
- Institucione kulturore;
- Manifestime kulturore;
- Manifestime argëtuese dhe sportive;
- Produktet e artizanateve si motive etnosociale.

Begatitë etnografike të Kosovës (veshja e llojllojshme dhe e larmishme, ndërtesat piktoreske rurale, begatitë e melosit etj) kaherë janë të njohura, dhe nga ky aspekt e bëjnë Kosovën trevë jashtëzakonisht tërheqëse.

**Burimet njerëzore,** paraqesin elementet bartës për ekzistencën dhe funksionimin normal të një biznesi. Aktiviteti i drejtimit të personelit është mjaft kompleks, ku implikohen operacionet me karakter administrativ, organizativ, ekonomik etj. për dallim nga sektorët e tjerë. Punësimi në sektorin e turizmit mund të jetë sezonal ose i përhershëm. Te punësimi sezonal stafi i angazhuar mund të jetë më pak i kualifikuar krahas punës së përhershme. Në turizmin kosovar mungesa e të dhënave të statistikës turistike për të punësuarit, nivelin e përgatitjes profesionale pamundësojnë që të bëhet një analizë më e hollësishme e burimeve njerëzore në
këtë sektor. Njëri nga faktorët më të rëndësishëm, për periudhën vijuese për zhvillimin e turizmit është përgatitja e kuadrit profesional turistik.
Turizmi kosovar ka mungesë të kuadrit profesional duke filluar nga mungesa e mësimdhënësve, të shkollave profesionale të turizmit, drejtimeve të reja turistike,
planprogrameve mësimore etj. Shkollat ekzistuese me drejtime të turizmit janë në kuadër të shkollave të profileve tjera profesionale dhe i përcjellë vështirësia e mungesës së objekteve ndihmëse ku mund të ushtrojnë pjesën praktike nxënësit e profileve turistike. Në Kosovë aktualisht funksionojnë numër i vogël i shkollave të mesme që në kuadrin e vet kanë drejtime të turizmit, ndërsa fakultete në sektorin publik drejtime të turizmit janë në Fakultetin e Biznesit në Pejë dhe Universiteti Privat “Pjeter Budi” në Prishtinë.

**Potencialet turistike në zonat rurale,** karakteristikat themelore të gjendjes aktuale të turizmit fshatar Kosovën e radhisin në regjione me resurse të konsiderueshme, por pa traditë fare në këtë lloj të turizmit. Karakteristikat e hapësirës, gjendja e biodiverzitetit, pozita gjeo-komunikatave, klima dhe vetitë tjera natyrore janë bazë e mirë për përfshirjen e turizmit rural në ecuritë e përgjithshme turistike të Kosovës, e sidomos zhvillimin e turizmit vendor. Numri i madh i resurseve turistike më atraktive, nuk janë as përafërsisht të valorizuar në masën e cila do të mundësonte plasman të suksesshëm në tregun turistik të vendit dhe të huaj. Shkaqet për këtë pozitë të turizmit rural janë të shumtë, por ndër më të rëndësishme janë:

- mungesa e përvojës, e vetëdijes për leverdinë ekonomike të një aktiviteti të tillë,
- mungesa e kulturës së përgjithshme të ekonomive familjare fshatare,
- mungesa e masave të politikës ekonomike në nivel të vendit për stimulimin e zhvillimit të turizmit rural,
- mungesa e bashkëpunimit me akterët tjerë të ofertës turistike të Kosovës etj.

Në rrjedhat bashkëkohore ekonomike zhvillimi i turizmit rural është pjesë e aktiviteteve komplekse të lidhura me rivitalizimin e fshatrave. Zhvillimi i turizmit rural mund të ndikojë në krijimin e kushteve për përmirësimin e gjendjes ekonomike-sociale, e sidomos të rajoneve ekonomikisht të pazhvilluara.
Zhvillimi i turizmit rural mundëson: përmirësimin e kualitetit të jetës dhe statusit material të banorëve në rajonet fshatare dhe ekuilibrimin e zhvillimit rajonal, ndërprerjen e migrimit të banorëve të fshatrave drejtë qendrave urbane dhe motivimin e të rinjve për kthimin në fshatra që do të ndikonte në ripërtrirjen e popullatës fshatare dhe përmirësimin e strukturës së popullatës aktive për punë, rritjen e prodhimit klasik bujqësor dhe plasmanin e produkteve sipas principeve të ekonomisë së tregut, afirmimi i programeve të prodhimit organik bujqësor, ruajtja e ekosistemeve natyrore dhe mbrojtja e biodiverziteteve, si dhe plasmani i kontrolluar i frutave pyjore, bimëve shëruese aromatike, rivitalizimi i potencialeve kulturore etj.

**Bujqësia dhe mundësitë e zhvillimit të turizmit rural,** sektori i bujqësisë mundë të jetë një burim potencial i rritjes së zhvillimit ekonomik të Kosovës. Kosova është e begatshme me tokë pjellore dhe klimë të butë, që është e përshtatshme për prodhimin e kulturave bujqësore.

Zhvillimi i bujqësisë e sidomos në viset rurale krijon parakushte për zhvillimin e turizmit rural. Kosova ka kushte shumë të mira për zhvillimin e turizmit rural por popullata në viset rurale ende nuk e ka përvojën e duhur për zhvillimin e këtij lloj turizmi. Turizmi rural, mundëson lidhjen midis turizmit dhe agrokulturës, të gjitha format që janë të përfshira në një zonë rurale. Për zhvillimin e turizmit rural, së pari duhet të dihet çka është turizmi rural, rëndësia e tij, përfitimet etj.
Turizmi rural mund të përkufizohet si një aktivitet i ndërmarrë nga popullsia rurale me qëllim për mbështetjen e rritjes së të ardhurave të tyre. Është një tip i turizmit që përdor në mënyrë efektive burimet e atyre zonave që nuk janë të banuara plotësisht.

**Rëndësia e zhvillimit të turizmit rural,** zhvillimi i turizmit rural mundëson:
Shpërndarje efikase hapësinore të përfitimeve ekonomike duke minimizuar problemet socio-ekonomike;

- Përdorimi optimal i përparësive relative dhe konkurruese;
- Rritje e fuqisë tregtare;
- Minimizimi i varfërisë nga zonat rurale turistike;
- Racionalizimi i dobësive ekonomike, social, ambiantaliste,
- Ofrimi konsumatorëve më shumë shërbime turistike;
- Rajoni krijon kushte më të mira për një turizëm të qëndrueshëm;
- Krijohen standarde më të larta cilësore jetësore.

Përfitimet nga zhvillimi i turizmit rural mund të jenë:

- Përfitimet sociale: rritja e infrastrukturës në një komunitet, krijimi i mundësive për ekspozim dhe shtrirje kulturore, zhvillimi i traditave dhe zakoneve kulturore,
- Përfitimet ekonomike: rritja e të hyrave valutore në zonë rurale, krijimi i mundësive për vende të reja pune, rritja e të ardhurave familjare, krijimi i efekteve të shumëfishta nëpërmjet zhvillimit të bizneseve tjera, nxitja drejt inovacioneve dhe rritja e krijushmërisë, dhënia e mbështetjes për shërbimet ekzistuese, mbështetje për zhvillimin e arteve dhe artizanateve lokale, ndikimi në banorët lokal, që të mos shpërngulen etj.

- Përfitimet mjedisore: promovimi për krijimin dhe mbrojtjen e fshatrave ekologjikisht të pastërta, ruajtja dhe mbrojtja e burimeve natyrore, rritja e rolit komercial në ripërtëritjen e burimeve natyrore, kulturore dhe historike.

**Rajoni qendror turistik i Prishtinës,** në këtë rajon turistik janë këto komuna: Prishtina, Besiana, Drenasi, Lypjani, Shtimja, Kastrioti dhe Fushë- Kosova. Në këtë rajon llogaritet në ecurinë e rëndësishme të turizmit transit dhe biznesi, Ndër atraksionet me të rëndësishme mund të veçohen: Parku nacional i Gërmisë, i Blinajës, Shpella e Gadimës, Liqeni Batllavës, Ulpiana, monumente tjera të trashëgimisë kulturore etj.

**Rajoni turistik i Alpeve Shqiptare,** këtë rajon turistik e përbëjnë komunat: Peja, Deçani, Gjakova, Burimi, Klina, dhe Rahoveci.
Ndër vlerat me të rëndësishme duhet të theksohen masivet malore të Alpeve Shqiptare, Gryka e Rugovës, fushat dhe kanjonet e Drinit të Bardhë, Lumëbardhi i Pejës dhe Deçanit, Erenikut, Ujëvara e Mirushës, liqenet malore, burimet termale, trashëgimia e pasur dhe e shumëllojshme e monumenteve kulturore-historike (zbulimet parahistorike), kishat mesjetare, xhamitë, hamamet, urat, hanet, etj.
Motive interesante të mjedisit dhe peizazhet (Çarshia e Gjakovës ,Çarshia e Pejës, vendbanimet fshatare, kullat, stanet në bjeshkë etj.
Pasuria etnografike dhe folklorike, veshja rugovase, vallet dhe këngët folklorike, zakonet tradicionale.

**Rajoni turistik i Sharrit,** në këto rajon turistik bëjnë pjesë këto komuna: Prizreni, Ferizaj, Kaçaniku, Shtërpca, Sharri, Theranda, Malisheva. Ky rajon turistik është mjaft i pasur me atraktivitete turistike në lokalitete të ndryshme turistike si të trashëgimisë kulturore, po ashtu, edhe të atyre natyrore. Ndër më të njohurat mund të veçohen: Kalaja e Prizrenit, Lidhja e Prizrenit, Gryka e Lumëbardhit, Qendra turistike në Brezovicë, Suka e Dermanit, Bifurkacioni Nerodimes, Shpella e Panorcit, Shpella e Petreshticës, Gryka e Kaçanikut, etj.

**Rajoni turistik i Mitrovicës,** ky rajon turistik përfshin këto komuna: Mitrovicë, Skenderaj, Vushtrri, Zubin-Potoku, Leposaviqi. Monumentet e trashëgimisë kulturore dhe natyrore e bëjnë mjaft tërheqës këtë rajon për turizëm. Ndër atraksionet turistike mund të veçohen: Shala e Bajgores me bukuritë e saj, liqeni i Gazivodes, banja Banjska, kristalet e Trepçës, monumente të trashëgimisë kulturore si Kalaja e Vushtrrisë, Hamami, Ura e gurit në Vushtrri, Kalaja e Zveçanit, disa lokalitete tjera të lashta që quhen gjytete etj.

**Rajoni Turistik i Anamoravës,** komuna e Gjilanit, Vitisë, Dardanes dhe Artanës e përbëjnë këtë rajon turistik. Edhe këto komuna me lokalitetet e veta kanë atraksione turistike që në të ardhmen mund të shfrytëzohen për zhvillimin e turizmit. Ndër më të theksuarat janë: burimet e ujërave termale Banja në Kllokët, në Kmetoc, Uglar, monumente të trashëgimisë kulturore si Kalaja e Artanës, Kalaja e Pogragjës, Kisha në Letnicë, Stubëll etj.

UNIVERSITETI I SHKENCAVE ORGANIZATIVE
PJETËR BUDI
INSTITUTI PËR STUDIME - PRISHTINË

**UNIVERSITETI "PJETËR BUDI " PRISHTINË**
**Fakulteti Turizëm dhe Hotelierisë**

KUSHTET PËR ZHVILLIMIN E TURIZMIT NË KOMUNËN E DRAGASHIT

Punoi: Shkelqim Halili

Tel : +381 38 234 566; +377 44 163 372; +386 49 163 372 e-mail: info@universitetipjeterbudi.com
www.universitetipjeterbudi.com

**PËRMBAJTJA**

- Profili komunal
- Trashëgimia natyrore në funksion të zhvillimit të turizmit
- Turizmi veror dhe dimëror
- Turizmi ditor dhe rekreative sportive
- Turizmi edukativ
- Turizmi i gjuetisë dhe peshkatarisë
- Turizmi malor
- Turizmi tranzitor
- Objektet hoteliere

## Profili komunal

Komuna e Dragashit përfshinë skajin jugor të rrafshit të Dukagjinit. Në veri kufizohet me komkunën e Prizrenit, në pjesën Jug-lindore dhe lindore, përmes majeve të larta të maleve të Sharrit, kufizohet me Maqedoninë, ndërsa nga Perendimi dhe Jug-perendimi me Shqipërinë.

Territori i komunës së Dragashit shtrihet në një sipërfaqe prej 435.25 km$^2$ dhe zë afro 4 % të territorit të Kosovës. Komuna e Dragashit ka reliev kodrinoro-malor, dhe në pjesët kufitare me Shqiprinë dhe Maqedonin e ndajnë kurora të larta malore, ndërsa në drejtim të Shqiprisë edhe gryka të thella lumore, të pa përshtatshme për kalim. Në anën tjetër pjesa kodrinore me rënje më të butë, në drejtim të Prizrenit ofron kushte më të mira dhe ky territor lidhet përmes Prizrenit me Kosovën dhe më gjërë. Klima e komunës është submalore në vendet më të ulëta dhe malore në vende të larta. Lumi i Pllavës me degët e veta formon sistemin më të madh lumor dhe përfshin rreth 63 % të territorit të komunës. Nga tërë sipërfaqja e kësaj komune, rreth 70 % janë sipërfaqe të mbuluara me kullosa.


Pozita gjeografike e komunës së Dragashit
SERBIA
MALI ZI
SHQIPËRIA
MAQEDONIA
Dragash
Legjenda
Qendrat komunale
Rruget magjistrale
Rruget regjionale
Hekurudhat
Airoportet
Kufijt komunal
Kufiri i Kosoves
N
W
E
S
0 5 10 20 30 40
Km

Ministria për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor
Instituti për Planifikim Hapësinor
Kuvendi komunal - Dragash
Nëntor, 2006




- Numri i banorëve në komunën e Dragashit vlerësohet rreth 47.000 banor.
- Në qytet jetojnë 1893 banorë (afërsisht 4 % e popullsisë)
- Në fshatra jetojnë 45646 (ose 96 % e popullsisë)
- Dendësia mesatare e popullsisë është rreth 109 ban/km²
- Ritja mesatare vjetore e popullsisë në këtë komunë është 1.7 %.
- Gjithsej në këtë komunë janë afër 7325 familje, me mesataren 6.5 anëtar.




- Etnitetet që jetojnë në këtë komunë janë: shqiptarë ~60 % dhe Boshnjakë/Goranë rreth 40 %.
- Gjithësej ekzistojnë 36 vendbanime.
- Ekzistojnë dy rajone: Opoja (e banuar me shqiptar dhe ka 19 fshatra) dhe Gora (e banuar me Goran ka 16 fshatra. Në mes gjendet qyteza e Dragashit me popullat të përzier.

Ministria për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor
Instituti për Planifikim Hapësinor
Kuvendi komunal - Dragash
Nëntor, 2006

**Trashëgimia natyrore në funksion të zhvillimit të turizmit**

Opoja dhe Gora disponojnë me kushte shumë të përshtatshme për zhvillimin e turizmit. Faktorët që do t'a mundësonin zhvillimin e turizmit janë: peisazhet e bukura të Sharrit, klima e shëndoshë, ajri i pastër, numri i madh i burimeve dhe gurrave të ftohta, numri i madh i lumenjëve dhe luginave atraktive, pyjet, flora dhe fauna, liqejtë, tradita dhe zakonet, folklori, terenet e përshtatshme për skijim.[6]Analizat e shumta që janë bërë në lidhje me zhvilimin e turizmit tregojnë se në komunën e Dragashit ekzistojnë predispozita për zhvillimin e turizmit si:

<u>Turizmi veror dhe dimëror</u> - Terrenet për skijim janë shumë të përshtatshme në malet e Brodit, Restelicës, Radeshës, Zaplluxhës etj. (u nevoitet një shtresë e hollë e borës)dhe mundësia e shfrytëzimit për skijim dimrit mund të zgjasë deri 6 muaj në vit. Kapaciteti i terreneve të skijimit të këtyre qendrave është diku 30,000 skijatorë. Në Zaplluxhe përveq skijimit në sezonin dimrorë (në borë), terenet janë të përshtatshme edhe për skijim në bar.




Turizmi ditor dhe rekreativo-sportiv - Sharri për nga numri i liqejve, pas Bullgarisë (malit Rilla) zë vendin e dytë në Evropë (edhe pse Opoja ka një dhe Gora ka dy liqej). Liqeni i Opojës është liqe i tipit karstik, relikt i liqenit të dikurshëm (uji i të cilit mbulonte tërë fushëgropën e Opojës) me diametër ~200m', me thellësi ~10m', shtrihet në l.m.b.940m' (pika më e ulët e Opojës ).

Liqejtë e Gorës janë Shutmani që shtrihet në l.m.b.2070m' dhe Defos që shtrihet në l.m.b.2112m'. Hapësira e vendndodhjes së këtyre liqejve është pa vegjetacion sepse kanë lartësi të madhe mbidetare, kanë formën e amfiteatrove dhe uji është i pastër e i ftohtë.[7]

Në strukturën e vegjetacionit, dominojnë kullosat, ndërkaç pyjet mbulojnë sipërfaqe simbolike. Livadhet shtrihen në afërsi tëvendbanimeve, pa marrë parasysh lartësinë mbidetare. Regjioni i Opojës dhe Gorës është shumë i pasur me bimë mjekësore, aromatike dhe bimë tjera të rëndësishme për industrinë farmaceutike, ushqimore dhe kozmetike. Të gjitha këto që u cekën e favorizojnë zhvillimin e turizmit veror në pikat e lartëpërmendura.[8]


www.macha-sharr.com



**Turizmi edukativ** - Bota bimore dhe shtazore, hidrografia dhe natyra e komunës së Dragashit në përgjithësi paraqesin burim potencial për zhvillimin e aktiviteteve hulumtuese të nxënësve, studentëve dhe shkenctarëve të ndryshëm mbrenda Kosovës por edhe të huaj.



Foto, Valanica - objekt unikat në Kosovë që daton prej 1800 e që edhe sot funksionon, bën prodhimin e zhgunës.

[2] Nga Mr. Hajriz Meloqi, Opoja dhe Gora – Vështrim gjeografik (Komuna e Dragashit)

**Turizmi i gjuetisë dhe peshkatarisë** - Gjuetia është duke u zhvilluar në mënyrë të kontrolluar, megjithate është e nevojshme që të shtohet kontrolli mbi gjuajtjen e kafshëve që janë autoktone në këto hapësira sepse është duke u rrezikuar numri dhe llojet e tyre. Lumenjtë dhe përrockat e komunës së Dragashit janë shumë të pasura me trofta malore. Edhe perkundër infrastrukturës së dobët turistike vizitorë të shumtë gjatë verës vijnë nëpër lumenjtë e Dragashit për gjuajtje sportive të peshqve.

**Turizmi malor** - Kushtet për zhvillimin e këtij lloji të turizmi janë ideale. Këtu vlen të veqohen terrenet me pjertësi të lehtë dhe shtigjet ekzistuese të cilat i përdorin blegtorët për bagëtitë e tyre paraqesin parakusht dhe mundësi reale për zhvillimin e alpinizmit, ecjes dhe të shëtitjes malore me biqikleta. Ky lloj i turizmit ka mundësi të zhvillohet por mvaret nga zhvillimi i qendrave rekreative në këto vende.

**Turizmi tranzitor** - Rruga Prizren - Restelicë - Strezimir (Kufi me Maqedoninë) Fushë e Radikës e cila lidhet me rrugen Gostivar - Mavrovë - Dibër - Strugë dhe Ohër (do të asfaltohet sivjet) dhe rruga e dytë në ndërtim e sipër Prizren - Zaplluxhe - Tetovë ku prej Zaplluxhës do të lidhet me Dragashin paraqesin dy segmente me rëndësi për zhvillimin e turizmit tranzitor në territorin e komunës së Dragashit. Hapja e këtij

[6] Materiali është marrë nga web-faqja e KK Dragash
[7] Nga Mr. Hajriz Meleqi, Opoja dhe Gora - Vështrim gjeografik (Komuna e Dragashit)

[8] Materiali është marrë nga web-faqja e KK Dragash

Ministria për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor
Instituti për Planifikim Hapësinor
Kuvendi komunal - Dragash
Nëntor, 2006

## Objektet hoteljere

- **.Hoteli " Sharr " i kategorisë B në Dragash I ka 24 dhoma dhe ai shfrytëzohet nga KFOR –i Turk ( prone e AKM ).**
- **Shtëpia e gjuetarëve në Brod me 3 dhoma dhe shtëpia malore në Radeshë ( prone e komunës ) me 2 dhoma nuk janë në gjendje momentale për të pranuar vizitor pa investime paraprake.**
- **Në qershor të vitit 2007 ka filluar edhe punën motel " Arxhena " në Brod me kapacitete 10 dhoma dhe në zgjerim e sipër i cili ka pregaditur edhe terrenin e vet për shijim duke ofruar edhe motoçikleta për skijim.**
- **Nga buxheti i konsoliduar I Kosovës është ndërtuar edhe rrjeti elektrik nga Zaplluxhja deri në qendrën e skijimit,gjithashtu është ndërtuar edhe rruga Prizren - Zaplluxhe – Qendër e skijimit – kufi me Maqedoninë me macadam ( shtresë guri para asfaltit ).***

  www.macho-sharr.com

# BIBLIOGRAFIA

1. -Ministria për mjedisin dhe Planifikimin Hapësinor
2. Instituti për Planifikim Hapësinor
3. Kuvendi komunal – Dragash
4. Nëntor,2006

5. -Mr.Hajris Meleqi,Oppooja dhe Gora-Vështrimi gjeografik (Komuna e Dragashit)

-Burime nga interneti:

1. www.macho-sharr.com